Emri i punimit	Quality Assessment Through Land Use Change, Land Surface Temperature – An Environmental Factors Analysis
Autori/et e punimit	Adem Dreshaj 1, Nimet Orqusha 2*, Violeta Berljolli 1, Arben Osmanaj 3
Roli i aplikuesit ne punim (ne reviste shkencore)	<input checked="" type="checkbox"/> Autor i pare
Emri i revistes	Ecological Engineering & Environmental Technology
Indeksi i revistes <sup>12</sup>	Q3
Vegeza per tek faqja informuese per revisten	<a href="http://www.ecoeet.com/Quality-Assessment-Through-Land-Use-Change-Land-Surface-Temperature-An-Environmental,187041,0,2.html">http://www.ecoeet.com/Quality-Assessment-Through-Land-Use-Change-Land-Surface-Temperature-An-Environmental,187041,0,2.html</a>
A jeni mbeshtetur financiarisht nga ndonje institucion tjeter vendor? Nese po, specifikoni.	JO

<sup>12</sup> Vetëm punimet e publikuara ne revista te indeksuara ne WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS do te mbështeten.

SHTOJCAT



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

GRUPI PËR KËRKIME SHKENCORE

Pejë, dt.

**Deklaratë nën betim**

Unë ADEM DRESHNI deklaroj nën betim më përgjegjësi etike, morale dhe disiplinore se për këtë punim për të cilin po aplikoj për mbështetje financiare pranë grupit për kërkime shkencore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk jam mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër.

Nënshkrimi i aplikuesit

Export all Save all to list

Sort by Date (newest) 

Article • [Open access](#)

## Quality Assessment Through Land Use Change, Land Surface Temperature – An Environmental Factors Analysis

Dreshaj, A., Orqusha, N., Berlajolli, V., Osmanaj, A.

*Ecological Engineering and Environmental Technology*, 2024, 25(6), pp. 200–207

Show abstract  Related documents

0

Citations





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>2482</u>	Nr. i faq/ Br. str / Np. pg <u>6</u>	
Data / Datum / Date: <u>27.09.2024</u> Pejë / Pcc		

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, lidhur me kërkesën e Prof. Ass. Dr. Thëlliza Latifi Sadrija, për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor titull "The power of education: How individuals and organizations shape the future" ne revistën Human Research in Rehabilitation e indeksuar ne SCOPUS (Q4). Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, morri këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa Prof. Ass. Dr. Thëlliza Latifi Sadrija për publikimin e punimit me titull "The power of education: How individuals and organizations shape the future" ne revistën Human Research in Rehabilitation e indeksuar ne SCOPUS (Q4).
- II. Shuma e aprovuar për mbështetje financiare për publikime shkencore të publikuara në SCOPUS, Q4, është në shumë prej **800 euro**, sipas nenit 11 të Rregullores për Veprimtari Kërkimore Shkencore të UHZ-së ref.nr. 846/24.
- III. Shërbimi financiar e procedon shumën e lejuar konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Emine Abdylj



Vendimi t'i dërgohet:

- Kryesueses së KD-së,
- Palës,
- U.d. Sekretares së Përgjithshme,
- Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa,
- Kryesuesit të IT-së,
- Arkivës së UHZ-së.







Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë

**Formulari për aplikim për mbështetje financiare për publikimin e Punimeve Shkencore në Revista Shkencore / Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore Ndërkombëtare**

**Informata për aplikuesit**

Emri dhe mbiemri	Thëllëza Latifi Sadrija
Data e lindjes	13.02.1986
Titulli/grada shkencore	Grada shkencore-Dr.Sc Thirja akademike -Prof.ass.dr
Njësia akademike (UHZ)	Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm Hotelieri dhe Mjedis
Fusha(t) e specializimit hulumtues	Menaxhim
Posta elektronike	<a href="mailto:thelleza.latifi@unhz.eu">thelleza.latifi@unhz.eu</a>
Numri i telefonit	049855502

**Informata për punimin shkencor**

Emri i punimit	The Power of Education: How Individuals and Organizations Shape the Future
Autori/ët e punimit	Thëllëza Latifi Sadrija, Alma Shehu Lokaj and Mersiha Kalac
Roli i aplikuesit në punim (në revistë shkencore)	<input checked="" type="checkbox"/> Autor i parë <input type="checkbox"/> Autor korrespondent
Emri i revistës	Human Research in Rehabilitation (HRR)
Indeksimi i revistës <sup>14</sup>	H-INDEX 3 SJR 2023-Q4 0.12
Vegëza për tek faqja informuese për revistën	<a href="https://human.ba/">https://human.ba/</a>

<sup>14</sup> Vetëm punimet e publikuara në revista të indeksuara në WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS do të mbështeten.

A jeni mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër vendor? Nëse po, specifikoni.	-
---	---

**Informata për konferencën shkencore ndërkombëtar /performancën artistike**

Titulli i konferencës shkencore/performancës artistike <sup>17</sup>	
Autorët e punimit/performancës artistike <sup>18</sup>	
A) Roli i aplikuesit në performancën artistike	<input type="checkbox"/> Solist <input type="checkbox"/> Mysafir <input type="checkbox"/> Korepetitor
B) Roli i aplikuesit në konferencë	<input type="checkbox"/> Prezantues i punimit në konferencë
Vegëza për tek faqja informuese për konferencën apo performancën	
A jeni mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër vendor? Nëse po, specifikoni.	

<sup>17</sup> Konferencat dhe performancat e realizuara në vendet fqinje të Kosovës, nuk do të mbështeten.

<sup>18</sup> Nëse aplikoni për mbështetje të pjesëmarrjes në performancë artistike, plotësoni njërin nga opsionet në rubrikën A. Nëse aplikoni për mbështetje të pjesëmarrjes në konferencë shkencore, plotësoni rubrikën B.

SHTOJCAT

GRUPI PËR KËRKIME SHKENCORE

Pejë, dt.

---

**Deklaratë nën betim**

Unë **Thëllëza Latif Sadrija** deklaroj nën betim më përgjegjësi etike, morale dhe disiplinore se për këtë punim për të cilin po aplikoj për mbështetje financiare pranë grupit për kërkime shkencore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk jam mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër.

Nënshkrimi i aplikuesit



---



## The Power of Education: How Individuals and Organizations Shape the Future

*Original scientific paper*

Thëllëza Latifi Sadrija, Alma Shehu Lokaj and Mersiha Kalac

<sup>1</sup>University "Haxhi Zeka", Pec/Pejë, Kosovo

Received: 2023/11/09

Accepted: 2023/01/21

### Abstract

*This article aims to explain and empirically prove that human resource management processes and practices influence individual and organizational performance, significantly contributing to the advancement of education in an organizational context. The reliability test was used to measure the level of internal consistency of the construct; Correlation analysis and OLS regression models were used to test the hypothesis. Questionnaires were distributed to 607 employees from 41 companies. The analysis shows that individual and organizational performance grew proportionally to the human resources selection process. There was a strong correlation between individual performance and education/training; a weak correlation between employee compensation and organizational performance; and a moderate correlation between individual performance and career development. Variables such as workforce competencies, motivation, and effective work structures had a strong effect on organizational performance. Based on the findings, we strongly recommend and encourage all companies in this study and beyond to develop a strategic plan to successfully guide their employees and implement processes and practices that improve individual and organizational performance, thus enhancing education in the business context. In the Balkan countries, especially in Kosovo, there is a lack of research on human resource management practices and processes. Therefore, this study will assist organizations in their efforts to improve HRM processes and practices, contributing to a better understanding and implementation of education strategies in organizational settings in this region.*

**Keywords:** *HRM processes and practices, individual performance, organizational performance, education, future*

Important in this paper is the objective which aims to highlight the importance of human resource (HR) processes and practices for individual and organizational performance. Since the success of an organization depends on skills and abilities, HR practices and processes play a crucial role in employee commitment.

Armstrong (2006) defined HR and (HRM) management as: "for the management of the most valuable assets of an organization, which are the people who work individually and collectively and contribute to the goals, a state-wise and coherent approach is used". Today, HRM-related issues are fundamental to the economy of every country.

**Correspondence to:** Alma Shehu Lokaj, University "Haxhi Zeka", Pec/Pejë, Kosovo  
E-mail: alma.shehu@unhz.eu

[Export all](#) [Save all to list](#)

Sort by [Date \(newest\)](#) 

Article • [Open access](#)

## The Power of Education: How Individuals and Organizations Shape the Future

Sadrija, T.L., Lokaj, A.S., Kalac, M.

*Human Research in Rehabilitation*, 2024, 14(1), pp. 94–106

[Show abstract](#)  [Related documents](#)

0

Citations







UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"



Këshilli Drejtues

Datë: 25.09.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me dt. 19.09.2024, ka shqyrtuar kërkesën lidhur me rekomandimin e Senatit nr. Ref. 2310, dt. 23.09.2024, të Prof. Dr. Sabiha Shala, dhe morri këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** rekomandimi i Senatit nr. Ref. 2310, dt. 23.09.2024, për Prof. Dr. Sabiha Shala, për shfrytëzimin e te drejtës për pushim me pagesë për vitin akademik 2024/2025, përkatësisht nga data 01.10.2024 deri 30.09.2025, lidhur me realizimin e projektit kërkimor "Integrimi Evropian i Kosovës dhe Modelet Evropiane për Mbrojtjen e Komuniteteve Jo- Shumicë".
- II. Obligohen Sherbimet Financiare që gjatë kësaj periudhe konform nenin 164 pika 3 e Statutit të UHZ-së që ti paguhet paga e plot çdo muaj.
- III. Në këtë periudhë kohore Prof. Dr. Sabiha Shala i lejohet mbajtja e mësimit online.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 19.09.2024, është njoftuar lidhur me kërkesën nr. ref. 2250 dt. 16.09.2024, e parashtruar nga Prof. Dr. Sabiha Shala që është drejtuar në senat për lejimin e shfrytëzimit të drejtës për pushim me pagës për vitin akademik 2024/2025 përkatësisht nga data 01.10.2024 deri 30.09.2025, lidhur me realizimin e projektit kërkimor "Integrimi Evropian i Kosovës dhe Modelet Evropiane për Mbrojtjen e Komuniteteve Jo- Shumicë". Në këtë periudhë kohore Prof. Dr. Sabiha Shala i lejohet mbajtja e mësimit online.

Duke u bazuar në Statut iu ka dhënë e drejta që të mos i ndalohet paga dhe të i lejohet realizimi i projektit kërkimor "Integrimi Evropian i Kosovës dhe Modelet Evropiane për Mbrojtjen e Komuniteteve Jo- Shumicë" në Universitetin e Francës.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së  
Prof. Ass. Dr. Emine Abdylj



**Vendimi t'i dërgohet:** Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"



Këshilli Drejtues

Data: 23.09.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, ka shqyrtuar kërkesën nr. Ref. 2060, dt. 22.08.2024, dhe morri këtë:

#### V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa nr. Ref. 2060, dt. 22.08.2024, Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, Prof. Ass. Dr. Mersiha Kalac Kacamakovic, profesoresha ne Fakultetit e Biznesit, parashtruan kërkesë për mbështetje financiare për vizitë studimore në Universitetin e Sarajeves nga data 02 deri 06 shtator 2024.
- II. Shuma e aprovuar **1,611 euro** (rimbursim)
- III. Shërbimi financiar e procedon shumën e lejuar konform dispozitave ligjore në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

#### Arsyetim

Komisioni për Kërkesa dhe Ankesa të drejtuara KD-së, në mbledhjen e mbajtur dt. 28.08.2024, ka shqyrtuar nr. Ref. 2060, dt. 22.08.2024, Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, Prof. Ass. Dr. Mersiha Kalac Kacamakovic profesoresha ne Fakultetit e Biznesit, parashtruan kërkesë për mbështetje financiare për vizitë studimore në Universitetin e Sarajeves nga data 02 deri 06 shtator 2024, qëllimi i vizitës është; realizimi i takimeve konsultative ndërmjet përfaqësuesve të instituteve, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave ndërmjet instituteve të US dhe UHZ-së, rishikimi i mundësisë së bashkëpunimit në projekte të përbashkëta, si dhe përgatitja e marrëveshjeve të mundshmen bashkëpunimi ndërmjet instituteve të Universitetit të Sarajevës dhe Institutit për Shkencë dhe Arte të UHZ-së. Shpenzimet e kalkuluar ne bazë të UA 2004/07 MSHP. Komisioni ka rekomanduar që kjo kërkesë të aprovohet.

Këshilli Drejtues i UHZ, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.09.2024 ka shqyrtuar raportin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave/ankesave drejtuar KD-së, dhe Këshilli drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Emine Abdyl



**Vendimi t'i dërgohet:**

- Kryesueses së KD-së,
- Palës,
- U.d. Sekretares së Përgjithshme,
- Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa,
- Kryesuesit të IT-së,
- Arkivës së UHZ-së.





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>2463</u>	Nr. / faq / Br. str / No. pg <u>1</u>	
Data / Datum / Dato: <u>27.09.2024</u> Pejë / Poç		

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024


Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit nr.04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, morri këtë:

### V E N D I M

- I. Themelohet komisioni për plotësim ndryshim të Rregullores nr. Ref. 2012/23 për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhje e Përgjithshme të Personelit Akademik dhe Jo Akademik në UHZ.
- II. Komisioni ka në përbërje këta anëtarë:
  - Dr. Sc. Gentiana Gega - kryetare
  - Haki Tigani - anëtar
  - Prof. Ass. Dr. Ylber Januzaj - anëtar
  - Prof. Ass. Dr. Fisnik Morina - anëtar
  - Jur. dip. Luan Lulaj - anëtar
- III. Të lartpërmendurit janë të obliguar që gjatë ushtrimit të detyrës t'i zbatojnë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara me Statutin nr.04-V-622 të UHZ-së.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Emine Abdyli



Vendimi t'i dërgohet:

- Kryesueses së KD-së, Rektorit,
- Të lartpërmendurve,
- U.d. Sekretares së Përgjithshme,
- Kryesuesit të IT,
- Arkivës së UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, ka shqyrtuar kërkesën nr. Ref. 017, dt. 17.09.2024, dhe morri këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa nr. Ref. 017, dt. 17.09.2024 e parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, për Organizimin e ditës së boshnjakëve.
- II. Shuma e aprovuar është 1,740.00 euro.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet kërkesa nr. Ref. 017, dt. 17.09.2024.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyefim

Këshilli Drejtues i UHZ-së, me datë 19.09.2024, shqyrtoj kërkesën nr. Ref. 017, dt. 17.09.2024 e parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, ku Instituti i Shkencës dhe Artit i Universitetit Haxhi Zeka planifikon të organizojë ligjërata me rastin e Ditës së Boshnjakëve të Kosovës më 27 shtator, ku do të marrin pjesë drejtorët e instituteve nga Universiteti i Sarajevës. Si të ftuar special priten drejtori i Institutit të historisë, prof. dr. Sedad Bešlija, dhe drejtori i institutit të gjuhës, prof. dr. Jasmin Hodžić, nga Universiteti i Sarajevës. Temat e ligjëratave do të jenë "HISTORIJA BOŠNJAČKOG NARODA" dhe "HISTORIJA BOSANSKOG JEZIKA". Në këtë organizim do të marrin pjesë deri në 100 pjesëmarrës, 2 prej të cilëve do të jenë prezantues kryesorë në ligjërata, ndërsa pjesa tjetër do të jetë menaxhmenti i universitetit, personel akademik nga Departamenti i Gjuhës Boshnjake, studentët dhe përfaqësues të komunitetit boshnjak. Për organizimin e këtij aktiviteti nevojiten mjete financiare në vlerë prej 1,740.00 €.

Këshilli drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së  
Prof. Ass. Dr. Emine Abojli



**Vendimi t'i dërgohet:** Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa, Kryesuesit të IT-së dhe Arkivës së UHZ-së.





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"



INSTITUTI PËR  
SHKENCË DHE ARTE  
UNIVERSITETI HAXHI ZEKA

PËR:	KËSHILLI DREJTUES, UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"
NGA:	PROF. ASS. DR. SUADA AJDARPAŠIĆ DREJTOR I INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE
LËNDA:	ORGANIZIMI I LIGJERATAVE

### KËRKESE

PËR ORGANIZIMIN E DITËS SË BOSHNJAKËVE 28. SHTATORI

Instituti i Shkencës dhe Artit i Universitetit Haxhi Zeqa planifikon të organizojë ligjërata me rastin e Ditës së Boshnjakëve të Kosovës më 27 shtator, ku do të marrin pjesë drejtorët e instituteve nga Universiteti i Sarajevës. Si të ftuar special priten drejtori i Institutit të historisë, prof. dr. Sedad Bešlija, dhe drejtori i institutit të gjuhës, prof. dr. Jasmin Hodžić, nga Universiteti i Sarajevës.

Temat e ligjëratave do të jenë "HISTORIJA BOŠNJAČKOG NARODA" dhe "HISTORIJA BOSANSKOG JEZIKA".

Në këtë organizim do të marrin pjesë deri në 100 pjesëmarrës, 2 prej të cilëve do të jenë prezantues kryesorë në ligjërata, ndërsa pjesa tjetër do të jetë menaxhmenti i universitetit, personel akademik nga Departamenti i Gjuhës Boshnjake, studentët dhe përfaqësues të komunitetit boshnjak.

Për organizimin e këtij aktiviteti nevojiten mjete financiare në vlerë prej 1,740.00 € me shpërndarje si në vijim:

Akomodim	2 persona nga BH, 2 netë, 80 € 2 * 80 € * 2 netë = 320 €
Transport	2 persona nga BH, 100€ për karburant 2 * 100 € = 200 € 1 person nga Prizreni, 30 € për karburant 1 * 30 € = 30 €
Dreka	25 persona, 20 € 25 * 20€ = 500 €

Pije (ujë, kafe)	100 persona, 1 ujë, 1 kafe 100 * 2€ = 200 €
Baner	1 baner = 100 €
Moderatori	200 €
Të tjera (sipas nevojës)	220 €
Gjithsej	1,740.00€

Agjenda e këtij organizimi është si në vijim:

<b>PROGRAMI I TRYEZËS SË RRUMBULLAKËT</b>	
<b>Dita e parë – 27.09.2023</b>	
10.30 – 11.00 11.00 – 11.20	Regjistrimi i pjesëmarrësve Fjala hyrëse: Moderatori  Fjala përshëndetëse: Prof. dr. Armand Krasniqi, Rektori i Universitetit “Haxhi Zeka” Prof. dr. Sedad Bešlija, Institut za historiju Prof. dr. Jasmin Hodžić, Institut za jezik
<b>LIGJERATA</b>	
11.20 – 12.00	Ligjërata I - “HISTORIJA BOŠNJAČKOG NARODA” Prof. dr. Sedad Bešlija
12.00 – 12.40	Ligjërata II - “HISTORIJA BOŠNJAČKOG JEZIKA”. Prof. dr. Jasmin Hodžić
12.40 – 13.00	Diskutim
13.00	Përfundim i organizimit
13.00 – 14.30	Dreka

### Arsyetimi:

Duke pasur parasysh se 28 shtatori është një ditë shumë e rëndësishme për të gjithë boshnjakët e Kosovës, e për rrjedhojë edhe për boshnjakët e rajonit, organizimi i këtyre ligjeratave, me rastin e asaj dite është një ngjarje shumë e rëndësishme për universitetin tonë, duke qenë se mësimi mbahet në gjuhën boshnjake në këtë universitet që nga viti 2002 dhe se universiteti ynë ka traditë të mbështesë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me veprimtaritë arsimore dhe kulturore-gjuhësore dhe historike të komunitetit kombëtar boshnjak.

Drejtor i Institutit për Shkencë dhe Arte

Prof. ass. dr. Suada Ajdarpašić



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REKTORATI	
Nr. / Br. / No. <u>2466</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>1</u>
Data / Datum / Date: <u>27.09.2024</u> Pojë / Pod	

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, lidhur me kërkesës e nr. Ref. 2259 dt. 16.09.2024. Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, morri këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa nr. Ref. 2259 dt. 16.09.2024, e parashtruar nga MSc. Gentiana Kastrati për ndarje të mjeteve buxhetore për angazhimin e ekspertes për mbajtje të trajnimit për standarde të reja të AKA-së
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 19.09.2024, kërkesa nr. Ref. 2259 dt. 16.09.2024, e parashtruar nga MSc. Gentiana Kastrati për ndarje të mjeteve buxhetore për angazhimin e ekspertes për mbajtje të trajnimit për standarde të reja të AKA-së. Zyra për sigurim të cilësisë dhe vlerësim ka planifikuar që trajnimi të mbahet me datë 25 dhe 26 shtator dhe shume e kërkuar për pagesën e ekspertes (Furtuna Memhemi) është 600 euro, dhe 200 euro për kafe dhe ujë gjithë trajnimit të stafit.

Këshilli Drejtues vendosen që të mos paguhet ekspertja pasi që detyre dhe përgjithësi për mbajtjen e këtij trajnimi i takon Drejtorit të zyrës për sigurim të cilësisë dhe koordinatoreve të cilësisë.

Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Emine Abdyl



**Vendimi t'i dërgohet:** Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa, Kryesuesit të IT-së, Arkivës së UHZ-së.





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024


Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, ka shqyrtuar kërkesën nr. Ref. 2262, dt. 17.09.2024, dhe morri këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa nr. Ref. 2262, dt. 17.09.2024 e parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Alma Shehu Lokaj - Prorektore për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore, për mbulimin e shpenzimeve të dy profesorëve nga Universiteti "Gaziantep" (Prof. Dr. Mehmet Ozaslan) dhe universiteti "Necmettin Erbakan" (Prof. Dr. Seyit Ahmeti KIRAY)
- II. Shuma e aprovuar është 600 euro.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet kërkesa nr. Ref. 2262, dt. 17.09.2024.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Emine Abdylj



Vendimi t'i dërgohet:

- Kryesueses së KD-së, Palës,
- U.d. Sekretares së Përgjithshme,
- Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa,
- Kryesuesit të IT-së dhe
- Arkivës së UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <b>2262</b>	Nr. i faq/ Br. str / N. pg <b>2</b>	
Date / Datum / Date <b>17.09.2024</b>		Pejë / Poë

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:	Këshilli Drejtues i UHZ		
CC:	Z. Armand Krasniqi – Rektor		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Anëtarë të Këshillit Drejtues të UHZ-së		
NGA/OD/FROM:	Znj, Alma Shehu Lokaj – Prorektore mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të dy profesorëve nga universiteti "Gaziantep" dhe universitetit "Necmettin Erbakan"		
Nr. i zyrës:	Lokacioni: Rektorat	Data:	17.09.2024
Br. kancelarije:	Kucni:	Datum:	
Room No.:	Extension:	Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			<input checked="" type="checkbox"/>

E nderuar kryesuese e KD-së, znj. Avdyli të nderuar anëtarë të Këshillit Drejtues,

Universiteti "Haxhi Zeka" planifikon organizimin dhe mbajtjen e konferencave ICRESS, ICRETS dhe ICMEHELS në korrik të vitit 2025. Konferencat janë planifikuar të mbahen njëkohësisht në kampusi i Universitetit të Pejës Haxhi Zeka më 10-13 korrik 2025. Këto konferenca janë mbajtur njëkohësisht në Lisbonë/Portugali, Berlin/Gjermani, Stamboll/Turqi, Baku/Azerbajxhan, Budapest/Hungari, Tashkent/Uzbekistan në vitet e mëparshme. Faqet e internetit të konferencave janë më poshtë. Konferenca Ndërkombëtare për Kërkimin në Arsim dhe Shkencë Sociale (ICRESS)

[www.icress.net](http://www.icress.net)

Konferenca Ndërkombëtare për Kërkimin në Inxhinieri, Teknologji dhe Shkencë (ICRETS)

[www.icrets.net](http://www.icrets.net)

Konferenca Ndërkombëtare për Shkencat Mjekësore, Shëndetësore dhe Jetësore (ICMeHELS)


[www.icmehels.net](http://www.icmehels.net)

Konferenca është një mundësi e mirë për komunitetin akademik të universitetit "Haxhi Zeka" dhe të gjithë partnerët e konferencës. Në konferencat paraprake pjesëmarrja e hulumtuese e ka kaluar numrin 1000 dhe kjo jo vetëm rrit reputacionin e universitetit "Haxhi Zeka" por gjithashtu hap dyer për bashkëpunime të ardhshme dhe rritje të komponentës shkencore në UHZ.

Për organizim dhe detaje të kësaj konference organizatorët Prof.Dr. Mehmet Özaslan nga universiteti "Gaziantep" dhe Prof Dr. Seyit Ahmet KIRAY nga universitetit "Necmettin Erbakan" do të vizitojnë universitetin "Haxhi Zeka" nga data 25 deri në datën 27.09.2024. Prandaj, kërkohet miratimi i buxhetit vetëm për akomodim dhe ushqim të profesorëve ta lartpërmendur nga data 25/09/2024 – 27.09.2024.

Me respekt,

Prof. Ass Dr Alma Shehu Lokaj





**SHPENZIMET PËR PROFESORËT NGA UNIVERSITETI "GAZIANTEP" DHE UNIVERSITETI "NECMETTIN  
ERBAKAN" PËR DATAT 25-27 SHTATOR 2024**

N r	Përshkrimi	Shuma
1.	Akomodimi në hotel me mengjes	65*2*3nete = 390euro
2.	Ushqimi për 3 darka + 2 dreka	105*2 =210euro
	<b>TOTALI</b>	<b>600euro</b>

\*Pagesa për ushqim bëhet sipas faturës



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET 'HAXHI ZEKA' PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2468	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 8	
Data / Datum / Date: 27.09.2024 Pejë / Poç		

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024 Pejë

Këshilli Drejtues, në bazë të nenit 17 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur, me datë 19.09.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Miratohet** Raporti i buxhetit të UHZ-së për periudhën 1 janar – 30 qershor për vitin 2024.
- II. Këtij vendimi i bashkëngjitet Raporti i buxhetit të UHZ-së për periudhën 1 janar – 30 qershor për vitin 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së  
Prof. Ass. Dr. Emine Abdyl



Vendimi t'i dërgohet:

- Kryesueses së KD-së
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm
- Prorektosës për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa
- Zyrës për financa
- Arkivës



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Adresa; Rruga e UÇK-së, se, 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Nr. tel + 381 039 432 270,

## RAPORT GJASHTËMUJOR I BUXHETIT

2024



Adresa; Rruga e UCK-së, 30000, Pejë, Republika e Kosovës

Nr. Tel + 381 039 432 270

[info@unhz.eu](mailto:info@unhz.eu)

## **Hyrje**

Ky raport përmban një përmbledhje të trendëve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës 1 janar deri 30 qershor të vitit 2024. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, siç vijon:

### **Përformanca e të hyrave**

**Të hyrat buxhetore (nga pagesat e studentëve)** gjatë gjashtëmujorit pranimet nga pagesat e studentëve ishin në shumë prej 16,188.50 euro ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka pasur rritje prej 21 %.

**Shpenzimet buxhetore:** Gjatë kësaj periudhe raportuese pagesat arritën vlerën prej 2,024,685.25 euro dhe paraqesin 85% të planit vjetor për shpenzime, ndërsa krahasuar me realizimin e vitit paraprak ka shënuar rritje prej 400,086.91 euro, që korrespondon më 32% krahasuar me vitin paraprak.

**Shpenzimet për paga dhe mëditje** shënuan vlerën prej 1,277,716.29 euro gjatë gjashtëmujorit, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 97% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Krahasuar me realizimin e vitit paraprak ka shënuar rritje prej 80,055.16 euro, që korrespondon më 7% krahasuar me vitin paraprak.

**Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 202,143.97 euro, duke shënuar rritje prej 20,482.04 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 47% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori, që korrespondon më 9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

**Shpenzimet komunale** shënuan vlerën prej 16,036.70 euro, duke shënuar rritje prej 887.33 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 35% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.

**Subvencione dhe transfere** mjete të buxhetuara për vitin 2024 janë 185,000 euro, ndërsa mjete të shpenzuara janë 13,000 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 7% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.


**Shpenzimet kapitale** shënuan vlerën prej 515,788.29 euro, duke shënuar rritje prej 422,727.14 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 100% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.

Detajet shpjeguese rreth buxhetit dhe shpenzimeve janë paraqitur në tabelat në vijim të këtij raporti për periudhën janar – qershor, 2024.



Detajet shpjeguese rreth buxhetit dhe shpenzimeve janë paraqitur në tabelat në vijim të këtij raporti vjetor për vitin 2024.

Kategoritë Ekonomike	Buxheti për vitin 2024	Buxheti i alokuar	Mjetet e shpenzuara	Zotimet/Obligimet e pashlyera	Fondet e pashfrytëzuara	Mjetet e angazhuara në %	Mjetet e shpenzuara në %
Raporti përmblthës i buxhetit për vitin 2024	4,445,115.19	3,773,778.44	2,024,685.25	1,189,242.27	559,850.92	85	54
Paga dhe Shtesa	1,986,707.19	1,315,370.44	1,277,716.29	-	37,654.15	97	97
Mallra dhe Shërbimet	603,000	603,000	202,143.97	83,403.85	317,453.18	47	34
Shpenzime Komunale	50,408	50,408	16,036.70	1,627.71	32,743.59	5	32
Subvencione dhe Transfere	185,000	185,000	13,000	-	172,000	7	7
Shpenzime Kapitale	1,620,000	1,620,000	515,788.29	1,104,211.71	-	100	32



## Paga dhe mëditje

**Shpenzimet për paga dhe mëditje** shënuan vlerën prej 1,277,716.29 euro gjatë gjashtëmujorit, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 97% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Krahasuar me realizimin e vitit paraprak ka shënuar rritje prej 80,055.16 euro, që korrespondon më 7% krahasuar me vitin paraprak.

Përshkrimi	2023	2024	Ndryshimi % (2024 - 2023)
	në Euro		
<b>1. GJITHSEJ PAGESAT</b>	<b>1,197,661.81</b>	<b>1,277,716.29</b>	<b>107%</b>
<b>1.1 Pagesat në total</b>	<b>1,197,661.81</b>	<b>1,277,716.29</b>	<b>107%</b>
Neto Pagat	997,517.50	743,239.90	75%
Pagesa e Kontributit Pensional nga punëdhënësi	56,425.70	59,678.96	106%
Pagesa e Kontributit Pensional nga i punësuari	56,425.70	59,678.96	106%
Tatimi në të hyra personale	86,812.46	92,921.51	107%
BSPK	480.45	622.77	130%
Përvoja e punës		37,996.51	-
Shtesa funksionale për arsimin universitar		3,183.33	-
Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës		198,379.71	-
Shtesat tranzitore		80,863.54	-
Funksionarët me kohë të pjesshme		1,151.10	-
<b>Totali</b>	<b>1,197,661.81</b>	<b>1,277,716.29</b>	<b>107%</b>

### **Pagesat për Janar – Qershor 2024 dhe krahasimet me vitet paraprake**

Universiteti "Haxhi Zeka" ka pasur shpenzime në njësi siç vijon:



- Fakulteti i Biznesit 449,245.06 euro;
- Fakulteti Juridik 190,124.18 euro;
- Fakulteti i Agrobiznesit 188,207.61 euro;
- Fakulteti i MTHM-së 139,909.93 euro;
- Fakulteti i Arteve 161,631.11 euro;
- Rektorati 148,598.40 euro;

#### **Mallra dhe shërbime**

**Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 202,143.97 euro, duke shënuar renje prej 20,482.04 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 47% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori, që korrespondon më 9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

<i>Përshkrimi</i>	<i>Shpenzimi 2023</i>	<i>Shpenzimi 2024</i>
<b>1. Mallra dhe shërbime</b>		
<b>1.1 Shpenzimet e udhëtimit</b>		
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit		
Mëditje për udhëtim zyrtar jashtë vendit(para xhepi)		435.60
Transporti për udhëtimit zyrtar jashtë vendit		2,795.76
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	2,516.56	
Shpenzimet tjera – udhëtimeve zyrtar jashtë vendit	8,036.67	6,698.78
Shpenzimet e vogla – para xhepi		
Akomodim i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	9,467.75	3,228.87
<b>Totali</b>	<b>20,020.98</b>	<b>13,159.01</b>
<b>1.2 Shpenzimet e Telekomunikimit</b>		
Shpenzimet e internetit	3,300.00	3,218.96
Shpenzimet e telefonisë mobile		1,979.08
<b>Totali</b>	<b>3,300.00</b>	<b>5,198.04</b>
<b>1.3 Shpenzimet për shërbime</b>		
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	350.00	300.00
Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse		750.00
Shtypje jo-marketing	3,470.00	
Shërbimet e shtypje/printimit		390.00
Shërbime tjera kontraktuese	54,187.31	60,153.96
Softuerët-licencat dhe mirëmbajtja e tyre		34,210.00
Shpenzimet për anëtarësim	200	200
<b>Totali</b>	<b>58,207.31</b>	<b>96,003.96</b>
<b>1.4 Blerja e mobileve dhe pajisjeve</b>		
Kompjuter më pak se 1,000		
Mobileje më pak se 1,000	7,349.00	

Pajisje tjera 1,000	7,225.00	
Blerja e librave dhe veprave artistike me pakë se 1,000	3,393.00	
<b>Totali</b>	<b>17,967.00</b>	
<b>1.5 Blerje tjera</b>		
Akomodim për mikpritje të delegacioneve të jashtme		2,050.00
Furnizim me preparate kimike		
Furnizim me veshmbathje	2,666.40	
Furnizim për zyrë	3,380.00	3,495.00
<b>Totali</b>	<b>6,046.40</b>	<b>5,545.00</b>
<b>1.6 Derivate dhe lëndë djegëse</b>		
Naftë për ngrohje qendrore	2,455.20	1,986.90
Karburant për vetura	2,171.14	1,799.42
Derivate për gjenerator		
Dru	6,540.00	5,360.00
<b>Totali</b>	<b>11,166.34</b>	<b>9,146.32</b>
<b>1.7 Llogaritë e avancit</b>		
Avance me para të imëta	500.00	500.00
Avance për udhëtime zyrtare	6,518.90	13,826.10
<b>Totali</b>	<b>7,018.90</b>	<b>14,326.10</b>
<b>1.8 Shërbimet e Regjistrimit dhe Sigurimeve</b>		
Regjistrimi i automjeteve	135.00	
Sigurim i automjeteve		
Taksa Komunale	10	
Sigurim i ndërtesave	33,217.92	32,237.13
<b>Totali</b>	<b>33,362.92</b>	<b>32,237.13</b>
<b>1.9 Mirëmbajtja</b>		
Mirëmbajtje dhe riparimi auto	122.88	
Mirëmbajtje e ndërtesave	19,698.00	16,415.00
Mirëmbajtje e tekno/info	32,848.88	484.21
Mirëmbajtje e mobileve/pajisjeve		
<b>Totali</b>	<b>52,669.76</b>	<b>16,899.21</b>
<b>1.10 Shpenzimet e marketingut</b>		
Reklama dhe konkurse		
<b>Totali</b>		
<b>1.11 Shpenzimet e përfaqësimit</b>		
Dreka zyrtare	12,856.40	9,529.20
<b>Totali</b>	<b>12,856.14</b>	<b>9,529.20</b>
<b>1.12 Vendimet e gjykatave</b>		
Pagesa me vendime gjyqësore		

<i><b>Totali</b></i>		
<i><b>Totali</b></i>	<u><b>222,626.01</b></u>	<u><b>202,143.97</b></u>

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 në raport me vitin paraprak ka pasur rritje të shpenzimeve për shkak të rritjeve të çmimeve në treg, janë paguar edhe obligimet nga viti paraprak.

Me këtë kategori janë paguar shpenzimet për kryerjen e aktiviteteve si në vijim:

- a) Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit;
- b) Shërbimet e telekomunikimit ( internet, telefona mobilë dhe shpenzime postare);
- c) Shpenzimet për këto shërbime:
  - I. Shërbimet e intelektuale këshillëdhënëse ( profesorët e jashtëm);
  - II. Shpenzimet e konsulentëve;
  - III. Shpenzimet e akreditimit, etj.
  - IV. Softuerët – licencat dhe mirëmbajtja e tyre;
- d) Blerja e mobileve dhe pajisjeve me vlerë më të vogël se 1000 euro, siç janë:
  - I. Inventari për salla të mësimi dhe për zyra;
  - II. Pajisje për salla të mësimi dhe për zyra;
  - III. Harduer për teknologji informative, etj.
- e) Blerja e të tjera mallrave dhe shërbimeve, siç janë:
  - I. Furnizim për zyrë ( materiale zyrtare, tonerë);
- f) Derivate për lëndë djegëse, siç janë: derivatet për vetura dhe gjeneratorë, pelet si dhe derivate për ngrohje;
- g) Shërbimet e sigurimit dhe regjistrimit, ku përfshihen sigurimi fizik i objekteve dhe sigurimi/regjistrimi i automjeteve;
- h) Mirëmbajtja, ku përfshihen: pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave brenda dhe jashtë, renovimet e ndërtesave, mirëmbajtja e teknologjisë informative, softuerëve dhe pajisjeve;
- i) Shpenzimet e marketingut, ku përfshihen botimet e konkurseve dhe të reklamave, etj.
- j) Shpenzimet e reprezentacionit.
- k) Buxheti i shpenzuar dhe i krahasuar me vitin paraprak.

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, gjatë vitit 2024, kontrata kornizë aktive, ka:

1. Sistemi Menaxhimit Universitar, pagesa mujore 5,285 euro vlera e mbetur është 65,210 euro;
2. Përkthimet në nivel të Universitetit vlera e mbetur është 4,297.46 euro;
3. Material promovues dhe shpenzues vlera e mbetur e kontratës është 64,483 euro;
4. Mirëmbajtja e ngrohjes, ujësjellësit dhe klimatizimit vlera e mbetur e kontratës është 41,006.10 euro;
5. Shërbimet e dizajnit dhe mirëmbajtjes së web faqes në vlerë prej 3,550 euro. Të gjitha shërbimet janë kryer sipas kontratës dhe lansimi i web faqes së re do të bëhet gjatë muajit shtator 2024.



6. Sigurimi fizik i objekteve pagesa mujore është 6,724.97 dhe vlera e mbetur e kontratës është 296,449 euro;
7. Mirëmbajtës i objekteve vlera mujore është 416 euro dhe vlera e mbetur e kontratës është 7,904 euro;
8. Ekspert për Teknologji të Informacionit vlera mujore është 750 euro dhe vlera e mbetur e kontratës është 14,250 euro;
9. Bashkëpunëtorë të jashtëm në Institutin për Shkencë dhe Arte, dy persona vlera mujore për person 650 euro vlera e mbetur për dy kontrata është 27,300 euro;

10. Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të brendshme vlera mujore është 6,820 euro me fakultetin e arteve duke qene se ende nuk është në funksion vlera e faktuarës momentale është 3720 euro dhe vlera e mbetur është 245,520 euro. Universiteti "Haxhi Zeka" gjatë vitit 2024 ka lidhur kontratë me Nr. 2086, datë 27.08.2024 në vlerë totale 245,520 euro.

Universiteti "Haxhi Zeka" gjatë TM2 ka iniciuar procedurat e prokurimit për zhvillimin e sistemit Anti-plagjiaturë për nevojat e UHZ-së, i cili ka qellim e verifikimeve të punimeve. Kontrata është lidhur më datë 01.07.2024 dhe është në vlerë prej 9,999 euro.


Universiteti "Haxhi Zeka" për shërbimet dhe furnizimet e tjera shfrytëzon kontratat e lidhura nga AQP. Universiteti "Haxhi Zeka" ka mbështetur gjithsej 26 personel në udhëtime zyrtare për marrëveshje, mobilitet, konferenca dhe vizita studimore në vlerë prej 24,315.51 euro, ndërsa nga projektet gjithsej janë 24 personel në vlerë prej 17,248 euro.

### Shpenzimet komunale

**Shpenzime komunale** shënuan vlerën prej 16,036.70 euro, duke shënuar rritje prej 887.33 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 35% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.

Përshkrimi	Shpenzimi 2023	Shpenzimi 2024
<b>Shpenzime Komunale</b>		
<b>Totali</b>	<b>15,149.37</b>	<b>16,036.70</b>
Shpenzimet e Rrymës	10,874.31	10,556.22
Shpenzimet e Ujit	2,661.04	3,832.49
Shpenzimet e Mbeturinave	933.18	1,091.99
Shpenzimet e Telefonisë	680.84	556.00

Siç shihet në tabelën e mësipërme UHZ-ja në periudhën e njëjtë raportuese ka pasur rritje të shpenzimeve nga viti paraprak në këtë kategori.



### Subvencione dhe Transfere

Mjete të buxhetuara për vitin 2024 janë 185,000 euro, ndërsa mjete të shpenzuara janë 13,000 euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 7% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.

- Mbulimi i shpenzimeve për punime të vitit janë 1,000 euro;
- Mbulimi i shpenzimeve për Hulumtues të vitit janë 2,500 euro;
- Mbulimi i shpenzimeve për publikimin e punimeve janë 11,100 euro;
- Mbulimi i shpenzimeve për bursa studentore (obligime nga viti i kaluar) janë 1,900 euro;

### Shpenzimet kapitale

*Shpenzimet kapitale, buxheti i ndarë sipas projekteve:*

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimi	Projekti
	në Euro		
<b>1. PROJEKTI – Buxheti kapitale</b>	<b>470,000</b>	<b>515,788.29</b>	
Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës	1,550,000	515,788.29	14027
Blerja e pajisjeve për UHZ-në	50,000		14050
Blerja e pajisjeve laboratorike dhe IT-së për UHZ	20,000		15255
<b>Totali</b>	<b>1,070,000</b>	<b>515,788.29</b>	

**1. Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës: Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë mjete të buxhetuara për vitin 2024 ka 1,550,000 euro të cilat janë për aktivitetet siç vijon:**

**1.1 Fakulteti i Arteve:** Duke u bazuar në Planin Urbanistik të zonës EST, ku është i vendosur kampusi i UHZ-së, në vitin 2017 UHZ-ja ka filluar ndërtimin e objektit për Fakultetin e Arteve me sipërfaqe prej ~5000 m<sup>2</sup>, gjatë vitit 2024 obligime kontraktuale kemi mjete në vlerë 118,916.09 euro. Aktualisht punimet kanë përfunduar dhe jemi në fazën për pranim teknik për fazën e IV dhe ekzekutimi i pozicioneve të paparapara dhe të pa parashikuara;

**1.2 Fakulteti i Biznesit dhe MTHM-së:** Universiteti “Haxhi Zeka” në vitin 2023 ka lidhur kontratë për ndërtimin e fakultetit të Biznesit dhe MTHM-së me sipërfaqe prej ~7000 m<sup>2</sup>, në vlerë prej 4,298,752 euro prej tyre gjatë vitit 2023 janë shpenzuar mjete në vlerë 1,429,875.20 euro ndërsa gjatë vitit 2024 mjete të shpenzuara janë 398,967.08 euro. Me datë 23.01.2024 është lidhur ankes kontratë në vlerë prej 99,181.02 euro të janë shpenzuar gjatë TM2;

**1.3 Kanali atmosferike:** me 15.11.2023 është lidhur kontratë për ndërtimin e kanalit të hapur atmosferikë në vlerë 41,750.76, gjatë vitit 2023 mjete të shpenzuara janë 32,815.76 euro.



Gjatë TM2 të vitit 2024 janë kryer punimet dhe është kryer pagesa për pjesën e mbetur prej 8,935 euro. Me 26.12.2023 është lidhur aneks kontratë në vlerë prej 3,881.02 euro dhe mjetet janë shpenzuar në vitin 2024;

2. **Blerja e pajisjeve për IT – blerja e Smartboard:** Universiteti “Haxhi Zeka” më datë 21.08.2023 ka bërë njoftimin për kontratë, hapja është bërë më 11.09.2023 ndërsa me 12.10.2023 është bërë njoftimi mbi vendim. Me datë 10.01.2023 sipas vendimit OSHP: 2023/0832 lënda është kthyer në rivlerësim. Më 25.01.2024 dhe 19.06.2024 janë themeluar komisionet për rivlerësim, komisioni i fundit ende nuk ka bere raport mbi punën e deleguar sipas vendimit Nr. 1618.
3. **Blerja e pajisjeve laboratorike dhe IT-së për UHZ:** Universiteti “Haxhi Zeka” ka filluar procedurat e tenderimit për blerjen e pajisjeve laboratorike për fakultetin e Agrobiznesit, në vlerë prej 20,000 euro (material shpenzues ne vlerë ~10,000 euro) tenderi është publikuar më 02.09.2024 dhe hapja do të bëhet më 23.09.2024 (nëse nuk ka ankesa).

## Përformanca e të hyrave

Të hyrat buxhetore (nga pagesat e studentëve) gjatë gjashtëmuorit pranimit nga pagesat e studentëve ishin në shumë prej 16,188.50 euro ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka pasur rreze prej 21 %.

Përshkrimi	2023	2024	%
	në Euro		
<b>1. GJITHSEJ TE HYRAT</b>	<b>20,588.00</b>	<b>16,188.50</b>	<b>79%</b>
<b>1.1 Të hyrat në total</b>	<b>20,588.00</b>	<b>16,188.50</b>	<b>79%</b>
Fakulteti i Biznesit	8,497.50	7,092.50	83%
Fakulteti MTHM-së	1,065	1,436.50	135%
Fakulteti Juridik	8,182	4,810	59%
Fakulteti i Artëve	1,012.50	1,296	128%
Fakulteti i Agrobiznesit	1,831	1,553.50	58%
<b>Totali</b>	<b>20,588.00</b>	<b>16,188.50</b>	<b>79%</b>

Te hyrat  
vetanake 21

Kategoritë Ekonomike	Buxheti për vitin 2023	Buxheti i alokuar	Mjetet e shpenzuara	Zotimet/Obligimet e pashlyera	Shpenzimet e planifikuara	Fondet e pashfrytëzuara	Mjetet e angazhuara në %	Mjetet e shpenzuara në %
<b>Totali</b>	25,536.99	21,579.50				21,579.50		
Paga dhe Shtesa	25,536.99	21,579.50				21,579.50		

Te hyrat dhe shpenzimet nga donacionet

Projekti	Nr. i projektit	Të hyrat 2024	Shpenzimi 2024
<b>QUADIC</b>	94996	7,152.70	7,152
<b>GREENWB</b>	92191	60,601.34	16,028
<b>ResearchCult</b>	92085		6,814.39
<b>ELEGANT</b>	92170	9,591.60	
<b>Totali</b>		<b>67,754.04</b>	<b>29,994.39</b>

## Përfundim

Në bazë të raportit të buxhetit vërehet çartë se menaxhimi financiar nga burimet financiare publike të cilat janë përdorur në nivelet më të larta të efijencës dhe efektivitetit, së bashku me integritetin dhe transparencën, dhe sipas gjithë asaj që është paraqitur në këtë raport tremujorë mund të konkludohet që këto parakushte janë arritur me mjaft sukses në të gjitha fushat e menaxhimit të financave në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, komfor legjislacionit në fuqi.

Shënimet për përpilimin e këtij raporti janë siguruar nga:

- 1) Zyrtari i shpenzimeve;
- 2) Zyrtari i të hyrave;
- 3) Zyrtari i pagave;
- 4) Sistemi për menaxhimin e financave publike SIMFK.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA E KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2469	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 5	
Data / Datum / Date: 27.09.2024 Pojë / Poč		

Këshilli Drejtues

Datë: 23.09.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, lidhur me kërkesën e Prof. Ass. Dr. Ylber Januzaj, për mbështetje financiare për publikimin e punimit shkencor titull "A textual content analysis model for aligning job market demands and university curricula through data mining techniques" në revistën International Journal of Interactive Mobile Technologies (IJIM) e indeksuar në SCOPUS (Q3). Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 19.09.2024, morri këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa Prof. Ass. Dr. Ylber Januzaj, për publikimin e punimit me titull "A textual content analysis model for aligning job market demands and university curricula through data mining techniques" në revistën International Journal of Interactive Mobile Technologies (IJIM) e indeksuar në SCOPUS (Q3).
- II. Shuma e aprovuar për mbështetje financiare për publikime shkencore të publikuara në SCOPUS, Q3, është në shumë prej **800 euro**, sipas nenit 11 të Rregullores për Veprimtari Kërkimore Shkencore të UHZ-së ref.nr. 846/24.
- III. Shërbimi financiar e procedon shumë e lejuar konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së


Prof. Ass. Dr. Emine Abdyl



Vendimi t'i dërgohet:

- Kryesueses së KD-së,
- Palës,
- U.d. Sekretares së Përgjithshme,
- Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa,
- Kryesuesit të IT-së,
- Arkivës së UHZ-së.





## UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"

### Formulari për aplikim për mbështetje financiare për publikimin e Punimeve Shkencore në Revista Shkencore / Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore

#### Informata për aplikuesin

Emri dhe mbiemri	Ylber Januzaj
Data e lindjes	01.07.1991
Titulli / grada shkencore	Profesor Asistent / Dr. sc.
Njësia akademike (UHZ)	Fakulteti i Biznesit
Fusha(t) e specializimit hulumtues	Machine Learning / Data Mining
Posta elektronike	<a href="mailto:ylber.januzaj@unhz.eu">ylber.januzaj@unhz.eu</a>
Numri i telefonit	049/666-626

#### Informata për punimin shkencor

Emri i punimit	A Textual Content Analysis Model for Aligning Job Market Demands and University Curricula through Data Mining Techniques
Autorët e punimit	Ylber Januzaj; Driton Sylqa; Artan Luma; Luan Gashi;
